

community

The New Apostolic Church around the world

04/2018/AI

Dalja e Apostulit të distriktit Markus Fehlbaum në pension

Editoriali:
Dhunti të larmishme

Shërbesa fetare: Dashuria
është më e madhja ndër to

Doktrina kishtare:
Lutja – e domosdoshme në
të gjitha situatat e jetës

New Apostolic Church
International



Dhunti të Iarmishme

Të dashur bashkëbesimtarë,

sapo njeriu tenton të krahasojë veten e tij me të tjerët, ai do të vërë re ndryshime të mëdha: ngjyrën e lëkurës, qëndrimin shoqëror, kombësinë, dhuntitë apo aftësitë si dhe çfarë ka në pronësi. Dhe në këtë krahasim merret shpesh për masë pozicioni, masa apo gjendja personale: Gjithçka që ndryshon konsiderohet dhe vlerësohet si ndryshe, shikohet me dyshim dhe ndonjëherë edhe paragjykohet apo dënohet.

Vetë Perëndia nuk bën dallime të tilla. Ai e do atë që është si ne. Por ai gjithashtu do edhe atë që është krejtësisht ndryshe nga ne. Ne nuk duhet t'i presim rrugën kësaj dashurie. Gjithkush duhet ta përjetojë dashurinë e Perëndisë në të njëjtën masë.

Përveç kësaj, ne duam të luftojmë së bashku për Perëndinë dhe me Perëndinë. Ndërsa ne jemi thirrur nga Perëndia, ne duam t'i shërbejmë Atij dhe duam të shpallim ungjillin me gëzim. Për këtë, ne kemi nevojë për njëri-tjetrin. Ne kemi nevojë për dallimet, ndryshimet tona. Kemi nevojë për dhuntitë e fqinjit tonë dhe ai ka nevojë për dhuntitë tona.

Ne konstatojmë se: Dallimet apo ndryshimet janë ende të dallueshme. Por ne nuk i perceptojmë dallimet dhe ndryshimet si një pengesë, nuk është më arsye për zhvlerësim apo dënim. Duke ditur se gjithkush kontribuon me dhuntitë e ndryshme, dallimet apo ndryshimet krijojnë një mundësi, një vlerë që shtohet për të gjithë.



Photo: NAC International

Si pjesë, si gjymtyrë të Trupit të Krishtit, ne duam t'i shërbejmë njëri-tjetrit. Brenda Kishës së Krishtit duam t'i vendosim dhuntitë tona në shërbim të Jezusit. Duke vepruar kështu, ne ndiejmë një mirënjohje të thellë për të gjithë të krishterët në të kaluarën dhe të tashmen, të cilët kanë vënë dhuntitë e marra nga Perëndia në shërbim të Krishtit dhe Kishës së Tij.

Dhuntitë janë shumë të ndryshme. Gjithkush kontribuon me dhuntitë e tij, me fuqitë e tij. Pa pasë nevojë për shpërblim - gjithmonë nga dashuria për Perëndinë dhe për tjetrin, të afërmin.

Të fala të përzemërta

Jean-Luc Schneider

Dashuria është më e madhja ndër to



Kjo shërbesë u transmetua nga kisha në Bern-Ostermundigen në bashkësitë e zones së punës të apostulit të distriktit

Photo: Jonas Spengler dhe Marc Genou

1. Korint. 13,13:

„Dhe tani, pra, këto tri gjëra mbeten: besimi, shpresa dhe dashuria; por më e madhja ndër këto është dashuria.“

Mire se erdhët në këtë shërbesë të sotme, të veçantë fetare. Është edhe një ditë e veçantë, e cila do të hyjë në historinë e këtij distrikti, pasi apostuli i distriktit do të dale në pension. Natyrisht që këtu nuk bëhet fjalë për të nderuar e lëvdur një njeri. Ne shfrytëzojmë rastin për të falenderuar Perëndinë tonë të dashur për atë, që ai ka bërë për ne në këto dhjetë vitet e fundit. Ne e falenderojmë Perëndinë e dashur për bekimin që ai na ka dhuruar nëpërmjet shërbimit të apostulit tonë të dashur të distriktit dhe që në këto dhjetë vite ku ai shërbeu Zoti qe me të. Ne e dimë se tashmë është fillimi i një periudhe të re në rrugën tonë drejt atdheut hyjnor, pikërisht ashtu siç e kënduan tani edhe këngëtarët e këngëtarët.

Me një makinë ndodh kështu, që njeriu mbas njëfarë kohe e çon për inspektim, për të parë nëse është çdo gjë në rregull apo jo dhe nëse janë në rregull të gjitha elementet e sigurisë. Është më mirë të kujdesesh më përpara. Ndoshta është mire, që edhe ne të bëjmë më parë një inspektim shpirtëror, për të parë nëse janë në rregull edhe elementet e sigurisë në shpirtin tonë. Le të hapim sot zemrën tonë, nën veprimin e Shpirtit të Shenjtë, për një inspektim shpirtëror. A është çdo gjë akoma në rregull, përse i përket sigurisë së jetës sonë shpirtërore? Çfarë kontribuon në sigurinë kur bëhet fjalë për shpëtimin tonë? Pikërisht ajo që Apostuli Pal i quan këtu pikat kyçe: Bëhet fjalë për besimin, për shpresën dhe për dashurinë. Unë reshershova dhe vura re, se ka kaluar një kohë shumë e gjatë, që kur një apostul kryesor ka shërbyer këty me këtë fjalë. Natyrisht e dimë, që besimi, shpresa dhe dashuria janë shumë të rëndësishme. Por, të dashur motra e vëllezër, këtu bëhet fjalë me të vërtetë për shpëtimin tonë. Është shumë e rëndësishme dhe vendimtare për këtë shpëtim, që të kemi brenda nesh aq besim, shpresë dhe dashuri, saç e dëshëron edhe Zoti.

Pika e parë që Pali ve në dukje është besimi. Sigurisht që besimi është jashtëzakonisht i rëndësishëm, pasi nga ai varet shpëtimi. Vetëm besimi mund të na shpëtojë. Vetëm besimi mund të na çojë tek Perëndia. Gjithshka varet nga besimi. Çdo gjë tjetër është dytësore. Pali shkroi atë, që ne ecim nëpërmjet besimit dhe jo nëpërmjet shikimit. Kjo do të thotë që, përse kohë Perëndia nuk ka ardhur akoma, përse kohë nuk ka përfunduar plani i Zotit për shpëtimin e shpirtave, njeriu duhet të besojë. Lidhja e tij me Perëndinë bazohet vetëm mbi besimin. Çfarë është besimi? Besimi është thjesht siguria, se ka diçka, të cilën nuk mund ta shohim, që nuk mund ta kuptojmë, që nuk mund ta imagjinojmë. Është thjesht ajo siguri e brendshme, se kështu është, por unë nuk mund ta shoh e ta imagjinoj. Ky është besimi. Është e rëndësishme që ne të jemi vazhdimisht të ndërgjegjshëm, se kemi nevojë për të deri në fund të jetës sonë. Çfarë besojmë ne? Ne besojmë, se Zoti është vetë dashuria. Ky është edhe themeli i besimit të krishterë: Zoti është dashuria! Ne besojmë në Trininë e

Perëndisë: Perëndinë At, Perëndinë Bir dhe Perëndinë Shpirti i Shenjtë. Këta të tre janë krejtësisht një dhe të lidhur ngushtë me njëri-tjetrin. Ky është me saktësi përkufizimi i dashurisë. Dashuria është në thelb kjo marrëdhënie që ekziston në Trininë midis Atit, Birit dhe Shpirtit të Shenjtë. Tre njerëz të ndryshëm janë plotësisht një, ju nuk mund t'i ndani ato, ata janë të lidhur ngushtë. Ky është përkufizimi i dashurisë. Ata nuk mund t'i ndash. Perëndia është vetë dashuria. Ne besojmë, se Perëndia është vetë dashuria. Perëndia, Trinia e tij ka krijuar njeriun: Le të bëjmë njerëz që janë të barabartë me imazhin tonë. Ai donte të përfshinte njeriun në këtë marrëdhënie, në këtë bashkim. Njeriu gjithashtu duhet të ketë pjesë në të, ta ndajë këtë dashuri. Por njeriu ishte i pabindur, u largua nga Perëndia. Ndërsa Perëndia është dashuria, i gjithë aktiviteti i tij synon që në fillim të rikthejë njeriun në këtë komunitet, për të rivendosur marrëdhënien midis Perëndisë dhe njeriut, në mënyrë që njeriu të mund të jetojë përsëri në një bashkim të përsosur me Trininë e Perëndinë.

Ne besojmë në Jezu Krishtin. Në dashurinë e tij, Perëndia dërgoi Zotin Jezus, Birin e tij në tokë, ai u bë njeri. Jezu Krishti na ka zbuluar thelbin, mendimet, vullnetin e Perëndisë. Ne e besojmë këtë. Ne e shohim Perëndinë, sepse e shohim Jezu Krishtin dhe kur dëgjojmë Jezu Krishtin dhe kur lexojmë fjalët e tij, e dimë që është Fjala e Perëndisë dhe

Ne presim lavdinë e përjetshme që do të bëjë që të gjitha vuajtjet dhe privimet tona të harrohen.





vullneti i tij. Ne besojmë tek Jezu Krishti, të cilin Perëndia me dashurinë e tij e dërgoi në tokë dhe që ai sakrifikoi jetën e tij. Kjo është mënyra, kjo është rruga që Perëndia, në dashurinë e Tij, na ka dhënë për të ardhur tek Ai.

Ne besojmë në Perëndinë, në Shpirtin e Shenjtë, në Krijuesin e Ri. Me dashurinë e tij, Perëndia dërgoi Frymën e Shenjtë në tokë. Ky Shpirt i Shenjtë po punon tani për të zbatuar dashurinë e Perëndisë dhe për të krijuar një krijim të ri. Ai krijon së pari një njeri të ri, krijon shpëtim, punon dhe plotëson planin e përsosjes dhe shpëtimin të Perëndisë. Perëndia është i pranishëm sot në tokë nëpërmjet Frymës së Shenjtë, atje punon dashuria e Perëndisë. Nëpërmjet Frymës, ai vazhdon planin e Perëndisë, me qëllimin përfundimtar për të sjellë të gjithë njerëzit në bashkësi me Perëndinë.

Pra, ne besojmë në Perëndinë, që është dashuria. Dashuria: përkufizimi, marrëdhënia e brendshme-trinitare, Perëndia dëshiron të marrë dhe ta fusë njeriun në këtë marrëdhënie, për këtë ai ka dërguar me dashurinë e tij Jezu Krishtin, Birin e Perëndisë në tokë, i cili ka bërë sakrificën e tij. Ne besojmë që Perëndia vazhdon të punojë me dashurinë e tij sot nëpërmjet Shpirtit të Shenjtë, të cilin nuk mund ta shohim, por e dime që kjo dashuri është vepër e Perëndisë. Ne besojmë në këtë. Për më tepër, ne besojmë se Perëndia



na ka dhënë Kishën, postin ose detyrën dhe sakramentet në dashurinë e tij dhe ne besojmë në premtimin që Jezusi dha dhe që Fryma e Shenjtë na e mban gjallë, Zoti do të vijë përsëri dhe pastaj dëshiron të ndërtojë mbretërinë e tij dhe të krijojë krijimin e ri për të gjithë njerëzit që do ta ndjekin atë pas. Ne besojmë në këtë. Është e rëndësishme që të mbetemi të vetëdijshëm për këtë. Besimi që kemi ndikon në besimin ndaj Zotit. Ne besojmë se Perëndia është dashuri, ne besojmë se dashuria e Perëndisë vazhdon të punojë dhe të sjellë shërim tek njerëzit.



Ne nuk dekurajohemi nga gabimet ose nga papërsosmëritë tona apo nga ato të të tjerëve

Sot nuk mund ta shohim gjithmonë këtë. Edhe nëse nuk e shohim, besojmë se Perëndia më do. Edhe nëse nuk e kuptojmë se çfarë po bën Perëndia, ne i besojmë atij, sepse besojmë që Perëndia im është dashuri, ai punon. Edhe nëse ndonjëherë çdo gjë shkon keq, ne besojmë tek vetja dhe kemi besim tek ai, Perëndia im është ajo që ne besojmë. Ai krijon shpëtim, punon për shpëtimin e të gjithë njerëzve. Kjo është e ardhmja. Ne i besojmë plotfuqishmërisë së Perëndisë, Perëndia është ashtu siç e besojmë ne. Duke besuar në Zotin, Jezus Krishtin, në Shpirtin e Shenjtë, ne besojmë në Kishë, në postin, në sakramentet, në të ardhmen. Kjo rrit besimin tek Zoti. Kjo është pika e parë e rëndësishme, i gjithë shpëtimi varet nga ajo.

Atëherë Pali e quan shpresën të dytën. Nga ky besim rritet një shpresë. Ne besojmë në qëllimin e Perëndisë. Ne e duam atë, e presim me durim dhe përgatitemi. Ky është përkufizimi i shpresës. Besimi i krishterë është thelbësisht i orientuar nga e ardhmja. E thashë në Uashington dy javë më parë, sepse më shqetëson fakti, kur shoh botën e krishterë.

Vihet re, që besimi ndonjëherë është ende i pranishëm, por është fashitur, reduktuar shpresa në të ardhmen, në jetën e përjetshme, në ringjalljen e parë, më vonë në shpëtimin në krijimin e ri, për të gjithë ata që e njohin Krishtin si Zotin. Ekziston një rrezik i madh për të krishterët, nëse mendojnë se besimi i krishterë është vetëm një etikë, një doktrinë që përcjell vlerat etike për të përmirësuar pak më shumë bashkëjetesën, jetën e përbashkët të njerëzve. Këto janë vlera etike që janë mjaft të mira, por ato mund të zëvendësohen me diçka tjetër. Aty ku besimi nuk është i lidhur me të ardhmen, kthehet në traditë ose moral, por nuk sjell shpëtim. Ky është me të vërtetë shqetësimi im, le të mbajmë fort shpresën.

Besimi ynë është i orientuar nga e ardhmja. Ne presim që Perëndia të përmbushë premtimin e tij. Ne presim për shpëtimin që Ai na jep. Ne jemi në fund duke pritur krijimin e ri. Të gjithë ata që e kanë pranuar Krishtin si Zot, do të gjejnë shpëtim. Shpresa është se ne e dimë se po vjen. Zoti Jezus tha se mbretëria e Perëndisë është tashmë midis jush, në mesin tuaj. Ju tashmë keni një hije të tillë. Pali thotë këtu, tani shohim një pamje të errët përmes një pasqyre. Ne tashmë kemi një ide të lavdisë, të përsosmërisë. Por gjithçka është ende shumë e paqartë. Por ne e dimë se po vjen, është gjithçka ende në përfundim. Krijesa e re që na ka dhënë Perëndia tashmë ekziston, por është ende në proces të bërjes. Kisha që ai ka dhënë është tashmë atje, por ende nuk është përfunduar, është ende në proces të bërjes. Shpëtimi që Ai dëshiron t'i japë të gjitha qenieve njerëzore tashmë ekziston, por është akoma në proces të bërjes, nuk mund ta shohësh siç duhet, por do të vijë, sepse Perëndia e premtoi. Perëndia është ajo që ne besuam. Do të vijë, ne do të përgatitemi. Kjo është shpresa, është tashmë atje, pak e perceptueshme, por gjithçka ende është në progres, ende e papërfunduar, jo e përsosur.

Kisha nuk është e përsosur, vëllezërit, postet nuk janë të përsosura, besimtarët nuk janë të përsosur, shpëtimi nuk është i përsosur, paqja nuk është e përsosur, etj. Gjithçka është në zhvillim e sipër. Kemi siguri se po vjen dhe ne po përgatitemi për të. Kjo shpresë na ndihmon të qëndrojmë të fortë, madje edhe kur bëhet fjalë për dështime, edhe pse duhet të kalojmë nëpër prova të shumta. Mbetemi të palëkundur me shpresën se ja vlen të qëndrojmë besnikë, se mbretëria e Perëndisë po vjen, ne po hyjmë në të, se do të jemi përjetësisht të gëzuar dhe të lumtur. Vetëm prisni, ia vlen të qëndroni besnikë.

Këtu-atje, vjen vdekja dhe dikush thotë, ja, tani ai vdiq, çfarë arriti? Jo, shpresa shkon përtej vdekjes, ajo shkon shumë më tej. Vdekja nuk është pengesë. Dikush mbetet i patundur, i



Apostuli kryesor Jean-Luc Schneider ndahet nga apostuli i distriktit Markus Fehlbaum (foto majtas) i cili del në pensionin e merituar dhe ngarkon me detyrën e re në postin e apostulit të distriktit Jürg Zbinden (foto djathtas)

vendosur në kundërshtim të tundimeve, edhe nëse duhet të ndodhë vdekja, kjo nuk e ndryshon shpresën tonë; kjo është e gjitha ende në zhvillim, por do të vijë! Perëndia na ka premtuar: Unë do të plotësoj atë që kam filluar. Për sa kohë që jeni dakort, unë do t'ju çoj në mbretërinë time. Kjo shpresë jeton ndër ne. Kjo është arsyeja pse ne nuk heqim dorë. Kur bie njëqind e pesëdhjetë herë, ne ngrihemi njëqind e pesëdhjetë e një herë. Ne vazhdojmë përpara. Për shkak se kemi këtë shpresë, ne pastrojmë veten, vazhdojmë të luftojmë kundër mëkatit, ne vazhdojmë të luftojmë për të dalë fitimtarë në jetën e re. Ne nuk heqim dorë nga shpresa. Ajo do të vijë, ne përgatitemi për të. Ne hedhim vështrimin nëpër botë dhe shohim vuajtjet, padrejtësinë, fatin e tmerrshëm të shumë njerëzve. Ne gjithashtu shohim njerëzit, të cilët janë krejtësisht larg Zotit. Dikush mund të humbasë zemrën, të dekurajohet. Kështu mund të thuash, çfarë po bën Perëndia yt? Perëndia ynë është në punë me anë të Shpirtit të Tij të Shenjtë, duke punuar në planin e tij për shpëtimin e të gjithë njerëzve. Kjo është ajo që vepra e Perëndisë po bën, punon nëpërmjet Shpirtit të Shenjtë. Ai vazhdon të punojë deri në fund. Ja vlen të vazhdojmë t'i shërbejmë Zotit dhe të vazhdojmë të sakrifikojmë për punën e Tij, të marrim pjesë në të, sepse plani ka marrë rrugë, askush nuk mund ta ndalë atë. Kjo është shpresa. Ne e dimë se po vjen, ne jemi duke e pritur atë. Ne e duam atë dhe përgatitemi për të. Ne presim me durim dhe luftojmë kundër mëkatit. Ja vlen t'i shërbejmë Zotit, dhe të sakrifikojmë për të. Ja vlen të përfshihesh në punën e tij, sepse e dimë mirë fundin e historisë.

Pastaj edhe një pikë të fundit: kjo është pak e çuditshme. Pali e quan të parin besimin, pastaj shpresën, dhe më në fund dashurinë. Të shumtët i numërojnë ato mbrapsht, por

ka një arsye për këtë, sepse kur besimi është i drejtë, kur ecën përpara me shpresë, dashuria rritet natyrshëm. Besimi na tregon, se Perëndia të do, Perëndia i do njerëzit. Ai na lejon ta përjetojmë këtë dashuri, ta kuptojmë atë. Shpresa na tregon gjithçka që Perëndia i dashur do të na japë. Nga kjo rritet dashuria reciproke, sepse Perëndia na do aq shumë, sa edhe ne e duam. Por kjo dashuri vjen nga besimi. Pa besim, kjo dashuri nuk do të ishte e mundur. Duhet të besojmë se Perëndia është vetë dashuria. Edhe nëse nuk e shohim, nëse nuk e kuptojmë atë, nëse nuk mund ta imagjinojmë atë, ne besojmë në të dhe e presim atë dhe prej saj rritet ajo dashuri. Pali thotë se besimi bëhet aktiv në dashuri. Ashtu si nuk është i vlefshëm një besim pa shpresë, ashtu edhe një besim pa dashuri, është një besim i vdekur. Dashuria është masa me anë të së cilës matet besimi. Pra, kjo varet nga besimi, por për të gjykuar atë besim, Perëndia shikon në dashuri. Ku ka besim të vërtetë, ka dashuri, dashuri për Perëndinë. Si shprehet kjo dashuri? Vetë Zoti Jezus tha: "Ai që më do mua i zbaton urdhëresat e mia. Ai që më do mua është i bindur". Shumë njerëz, madje shumë të krishterë, kanë një ide tjetër të dashurisë. Ju nuk mund ta ndryshoni atë, kjo është një fjalë e Jezu Krishtit. Jezusi e përkufizoi këtë. Besimi matet me dashurinë, kushdo që më do mua, ndjek urdhëresat e mia. A kemi akoma dëshirë të singertë për të jetuar sipas urdhëresave të Perëndisë, a kemi atë dëshirë të thellë për të ecur në përputhje me ligjin e Perëndisë dhe për të bërë jetën tonë në këtë mënyrë? Ai që më do mua, zbaton urdhëresat e mia.

Kur e dimë, se besimi është i rëndësishëm dhe Perëndia e mat besimin në dashurinë dhe e përcakton dashurinë me besnikërinë ndaj besimit, atëherë dashuria nuk bëhet aq e rehatshme.

Urdhëresa tjetër që ka dhënë, urdhëresa e dashurisë ndaj tjetrit: nëse e kemi këtë shpresë, Perëndia na ka premtuar miqësi me të, ne e duam atë, prandaj dhe përgatitemi. Çfarë do të thotë kjo, të përgatisim veten? Ne e përgatisim veten për t'u bashkuar me Perëndinë dhe e rregullojmë veten në mënyrë që të bëhemi një me të sot, që mendimet dhe qëndrimet e tij të bëhen mendimet dhe qëndrimet tona. Si mendon Jezusi? Ai e do fqinjin tim ashtu si më do mua. Për shkak se kemi këtë shpresë, këtë dëshirë të madhe për të ardhmen, këtë dëshirë të zjarrtë për bashkimin me Perëndinë, ne po përgatitemi që sot. Ne përpiqemi vazhdimisht të rritemi në mendjen e Jezu Krishtit. Jezu Krishti është Perëndi, Perëndia është dashuri, ai e do fqinjin tim, kështu përshtaten këto së bashku. Unë po rritem në dashuri, sepse kam këtë shpresë, po pres bashkimin, po përgatitem për bashkimin me Perëndinë, Perëndia është dashuri, kështu që unë duhet të jem dashuri gjithashtu. Kjo është arsyeja pse dashuria është pafundësisht e rëndësishme. Pra, besimi është një gjë e mirë, ndikon në shpresë dhe matet me dashuri.

Tani po arrij në përfundim: Pali thotë, se mbetet besimi, shpresa, dashuria. Këto janë parimet themelore, por dashuria është më e madhja mes tyre. Pali nuk thotë se dashuria është më e rëndësishmja, por më e madhja. Dhe kjo është ajo që ai shpjegon, sepse në një farë kohe besimi do të ndalet. Kur të kalojë koha e besimit, atëherë shohim atë që kemi besuar. Pastaj besimi ndalet. Sot ne mund ta përjetojmë besimin herë pas here. Kjo përvojë na forcon ne në besimin tonë. Kur të jemi me të, nuk kemi nevojë të besojmë më, atëherë gjithçka është si në pëllëmbën e dorës, gjithçka është e qartë. Shpresojmë, ne presim diçka, dhe këtu kemi një shijim të vogël në Darkën e Zotit, në bashkësi. Është mirë të shihet se çfarë mund të jetë shoqëria me Perëndinë, por është vetëm një shije. Por në një farë pike Perëndia do të përmbushë premtimin e tij, atëherë nuk do të kemi më nevojë për shpresë. Ne pastaj jetojmë në këtë realitet. Ne mund ta përjetojmë dashurinë në shumë mënyra sot, por ajo kurrë nuk do të ndalet. Pse? Kthehem në fillim. Ne pastaj zhytemi në këtë marrëdhënie me Perëndinë, pranoemi atje ku mund të jetojmë, kjo marrëdhënie është dashuria. Kur e arrijmë atë, kur arrijmë qëllimin, atëherë ne jetojmë në dashurinë e Perëndisë, kemi këtë bashkim të ngushtë me Perëndinë, jemi plotësisht një me Të, jemi pranë Tij dhe askush nuk mund të na ndajë më prej Tij. Kjo është dashuria. Pra, dashuria nuk shterron kurrë, ajo së fundi do të përsoset, kur ne të jetojmë të bashkuar me Perëndinë. Çfarë ndodh me dashurinë ndaj tjetrit? Edhe ajo nuk shterron kurrë, ajo do të përsoset gjithashtu, sepse do të jemi të gjithë në sallën e martesës, në Krijimin e ri. Njerëzit jetojnë në rrethana të reja, atëherë të gjithë janë të mbushur plot me dashurinë e Perëndisë. Në këtë lidhje të

ngushtë me Perëndinë, marrëdhënia midis njerëzve është mjaft e ndryshme. Çdo gjë që është mëkatore është zhdukur, gjithçka njerëzore ka ikur, të gjithë janë të orientuar nga Perëndia, Perëndia është gjithçka në të gjitha, marrëdhënia mes vetë njerëzve është një marrëdhënie hyjnore e bazuar në Perëndinë, e mbushur me dashurinë e Perëndisë. Qëllimi i gjithë ngjarjes është dashuria e përjetshme, që të jetojmë përjetësisht në bashkësi me Perëndinë dhe që midis njerëzve të jetë një imazh i tillë i marrëdhënies trinitare. Marrëdhënia e të gjithë njerëzve bazohet vetëm në dashuri. Kjo është e ardhmja jonë.

Këto janë disa mendime rreth këtyre tri koncepteve qendrore: besimit, dashurisë dhe shpresës. Do të bëjmë mirë ta mbajmë këtë në mendje. Çfarë mendoj unë në të vërtetë? Cfare besoj unë? Me kalimin e kohës ka zënë kaq shumë pluhur mbi të dhe nganjëherë e ngatërrojmë besimin me diçka tjetër, me traditën e me ndonjë gjë tjetër. Le t'i shkojmë deri në fund kësaj. Çfarë besojmë, në çfarë besojmë në të vërtetë? Nga kjo rritet shpresa dhe dashuria. Pa shpresë besimi ynë është i vdekur, besimi matet me dashurinë.

Qëllimi është që të pranoemi përjetësisht në dashurinë e Perëndisë, ne dhe të gjithë njerëzit e tjerë. Kjo është dëshira jonë, ky është qëllimi ynë. Amin.

MENDIME KYCE

Besimi, shpresa dhe dashuria janë të pandashme dhe po aq të domosdoshme për shpëtimin. Ne besojmë se Perëndia është dashuri dhe kemi besim tek ai. Ky besim prodhon shpresë dhe dashuri. Ne presim me durim shpëtimin dhe përgatitemi në mënyrë aktive për të. Ne e reflektojmë dashurinë e Perëndisë, duke iu bindur urdhëresave të Tij dhe duke dashur sipas shembullit të Jezusit.



Photo: NAC Afrika e Jugut

Udhëtim me anije dragoi (Drachen-boot)

Globi është i rumbullakët dhe i madh: Kudo ka bashkësi apostolike të reja – të pasura në traditat dhe në kulturat e tyre. Ka shumë gjallëri, plot ngjyra e të gjithë së bashku nën një çati.

Një ngjarje tjetër e re për të rinjtë e zonës kishtarë të Afrikës së Jugut që përsëri edhe udhëtimi vjetor me anije dragoi (Drachen-Boot-Regatta) përgjatë Canal Walk në Century City në mes të Kapshtad-it. Mbas Ditës së Rinisë aq të gjallë dhe entuziaste në Kapstadt-Stadion në shkurt 2018, që këtë radhë më 2 prill edhe vendtakimi i shumë bashkësive. 60 skuadra marshuan nga Langebaan në perëndim deri në Gauteng në verilindje. Mijëra spektatorë, përfshirë këtu edhe apostulin e distriktit John Kriel, brohorisnin plot zjarr për skuadrën e tyre. Së fundi garën finale e fitoi skuadra e Northpine Vikings, duke mbrojtur kështu titullin e një viti më parë. Edhe pse ekzistoi natyrshëm një rivalitet sportiv, gëzimi i atij bashkimi, i atij takimi që u përjetua, që shumë më i madh se gjithshka.



PALI BLOKOHET NË MALTË

(SIPAS VEPRAVE TË APOSTUJVE 27 DHE 28)

Pali do të dërgohej me anije sëbashku me të burgosur të tjerë për në Romë. Në rrugë për atje filloi një stuhi e fortë. Ndërsa anijen e ankoruan në Kreta, apostuli i këshillon drejtuesit e anijes që të mos ndalojnë. Por kapiteni nuk e dëgjon Palin.

Era kthehet në një stuhi të madhe. Ekuipazhi përpiqet më kot për të rregulluar anijen. Ditën tjetër ata hedhin ngarkesën jashtë bordit. Stuhia nuk ndalet. Një ditë më vonë, hedhin edhe veglat e punës, sendet me vlerë, me qëllim që anija të lehtësoj sa më shumë.

As dielli e as yjet nuk shikoheshin në qiell. Në atë kohë jashtëzakonisht të keqe udhëtarët humbasin çdo shpresë. Porse Perëndia, nëpërmjet një engjëlli, i thotë Palit, se të gjithë 276 njerëzit në anije do të mbijetojnë.

Kaluan katërmëdhjetë ditë e netë. Eshtë mesnatë. Marinarët hedhin jashtë lidhësin matës dhe shohin se uji nuk është i thellë. Kanë frikë se mos ndeshin në ndonjë shkëmb. Disa nga marinarët po përpiqeshin të largoheshin me një varkë të vogël. Por Pali paralajmëron: në qoftë se nuk do të qëndrojmë të gjithë sëbashku në bord, nuk do të shpëtojmë.

Pak para agimit, Pali këshillon bashkëudhëtarët për të ngrënë diçka. Ai merr bukën, falënderon Zotin, e shpërndan atë dhe fillon të hajë edhe vetë.

Kur bëhet dritë, ekuipazhi përpiqet të sjellë anijen në breg, por bashi, maja e saj përplasat në rërë dhe thyhet. Disa dalin me not, të tjerët kapen pas dërrasave dhe trarëve të anijes së shkatërruar. Të 276 njerëzit arrijnë të dalin gjallë në breg. Ata shpëtuan. Ishulli, mbi të cilin arritën të dilnin, quhej Malta. Banorët e ishullit marrin miqësisht e mbijetuarit nga anija e shkatërruar. Për shkak se binte shi dhe bënte ftohtë, ata ndezin një zjarr për ta. Edhe Pali mbledh degë të thata. Ndërsa dëshëron të hedhë mbi zjarr turrën e degëve, del

papritur nga turra e druve, i frikësuar nga zjarri një nëpërkë. Ajo e pickon fort Palin në dorë. A duhet të kish qenë më kot shpëtimi nga stuhia?

Banorët e ishullit pyesin njëri-tjetrin:

„A është ky njeri një vrasës? Së pari shpëton nga deti dhe pastaj i duhet të vdesë nga një gjarpër. Për çfarë është kjo hakmarrje?“

Pali e hedh gjarprin në zjarr.

Banorët e ishullit presin, që t'i fryhet dora apo që Pali të bjerë i vdekur në tokë. Ata pritën gjatë, por asgjë nuk ndodhi.


Dukej sikur Palin të mos e kishte kafshuar gjë.

Publisi, njeriu më i respektuar në ishull, fton

Palin të jetojë në shtëpinë e tij. Babai i tij është i sëmurë dhe ka temperaturë të lartë.

Pali shkon tek ai, lutet me të, i vë duart mbi të dhe e shëron.

Pastaj vijnë të sëmurët e tjerë të ishullit dhe shërohen prej Palit.



PËR VIZITË TEK DAMIANI NË DOHA (KATAR)

Mirë se erdhët në Katar! Unë quhem Damian dhe jam 13 vjeç. Unë banoj së bashku me prindërit e mi dhe vëllanë tim Dillon (15 vjeçar) në Doha, kryeqyteti i vendit. Katar shtrihet në Lindjen e Mesme, ju do ta gjeni atë në gadishullin e Arabisë Saudite, në verilindje të tij.



Këtu banojmë ne, këtu është edhe dera e shtëpisë. Prindërit e mi janë me origjinë nga Afrika e Jugut dhe para shtatë vitesh u transferuan në Katar, pasi babai im ka gjetur këtu një punë të mirë. Ai është nëndrejtor i një firme të madhe projektuese në aeroport, mamaja ime jep muzik në shkollën ku mësoj unë. Në Katar banojnë shumë të huaj, vetëm një në nëntë banorë është vendas. Shumica e të huajve kanë ardhë këtu për të punuar në industrinë e naftës dhe gazit. Këto pasuri nëntokësore e kanë bërë vëndin të pasur.

Një foto me shokët e mi, është marrë gjatë festimit të një ditëlindjeje në restorat.

Babai im është edhe drejtuesi i bashkësisë. Përveç kësaj ai këndon në korr dhe luan në organo. Mamaja ime drejton korrin dhe luan po ashtu edhe në organo si dhe oboj në orkestër. Familjes time i jepet shumë për muzikë siç e shikoni edhe në foto: Unë luaj në violinçel, vëllai im ka zgjedhur Keyboard-in.



Shërbesat fetare zhvillohen në një qendër për të krishterët. Atje ndodhet një dhomë e vogël, sa për të vendosur disa karrige e një tavolinë, e cila shërben si altar. Në një dollap kemi mbulesën, Keyboard-in, librat e këngës, dhe mbajtësen e notave për dirigjentin. Ne e bëjmë gati këtë dhomë përpara çdo shërbese.

Kjo është shkolla, ku unë shkoj. Lëndët e mija më të preferuara janë Gjeografia, Teatri, Sporti dhe Historia.

Çfarë unë nuk pëlqej janë: të luaj Rugby, anglishtja dhe domatet. Çfarë më pëlqen: të luaj me Playstation ose në Tablet, më pëlqejnë makaronat me djathë, Futbollit dhe të tjera lloje sportesh.



Në vitin 2022 do të zhvillohet në Katar kampionati i futbollit. Me qenë se në verë temperaturat janë shpesh mbi 40°C, kampionati i futbollit do të zhvillohet në dimër. Atëhere temperaturat janë mesatarisht 17 deri më 20°C.





Lutja – e domosdoshme në të gjitha rrethanat

Përse lutemi ne? Çfarë e bën një lutje me të vërtetë lutje? Dhe çfarë nevojitet për të pasë një jetë aktive në lutje? Mendime rreth dialogut me Perëndinë - të shkruara nga apostuli kryesor.



Kur dikush flet për lutjen, mund të mendoni së pari për lutjet brenda shërbesës fetare. Në to janë elemente thelbësore, adhurimi, falenderimi, lutja për vete dhe ndërmjetësimi për tjetrin. Lutjet, të cilat thuhën brenda shërbesës fetare, nuk janë shprehje e falenderimit, e dëshirave apo shqetësimeve të atij që po shërben, porse ato shprehin qartë gjithshka, që prek dhe shqetëson të gjithë bashkësinë.

Ajo lutje që bëhet aq hapur në shërbesë fetare i udhëzon e i mëson gjithnjë pjesëmarrësit atje, se sa e rëndësishme dhe e domosdoshme është lutja private për jetën. Lutja në shërbesën fetare duhet të inkurajojë për t'u lutur vetë dhe pikërisht jo vetëm në situata të vështira, ku ndoshta dyshon e nuk sheh më asnjë rrugëzgjdhje, porse në të gjitha rrethanat.

Shprehje e besimit dhe e bashkimit

Lutja është një shprehje e rëndësishme për bashkimin e Perëndisë me njerëzit. Tek Katekizmi shkruhet për këtë: „Gjatë lutjes besimtari përjeton se: Perëndia është prezent, Perëndia dëgjon, Perëndia përgjigjet“ (KNK 13.1).

Për disa kjo lutje personale, të cilën e quajmë tradicionale, ka dalë në sfond, në plan të dytë. Prandaj është e domosdoshme, të reflektojmë e të kthehemi në rrugën e lutjes. Për këtë njeriu duhet të lutet rregullisht me fëmijët, aq më tepër kur ka përgjegjësi në rritjen e tyre në besim, me qëllim që ata të mësojnë, se lutja nuk i përket vetëm kur mbahen shërbesat fetare, por edhe në jetën e përditëshme.

Kur ne lutemi, kjo është në rradhë të parë një shprehje e besimit tonë, se pa besimin tek Zoti, nuk kanë kuptim as fjalët dhe as dëshirat që i drejton atij. Besimtari e di mirë ama se: Perëndia është i arritshëm dhe ai përgjigjet. Njeriu është krijesa e Perëndisë, imazhi i tij dhe për këtë arsye Perëndia i drejtohet atij.

Kush e kap, e merr mundësinë e lutjes do të përjetojë gjithashtu, se Perëndia është homologu ynë, i cili dëgjon dhe përgjigjet. Kjo përvojë shërben gjithashtu për ta njohur dhe përjetuar Perëndinë, për të kuptuar se ai interesohet edhe për gjëra të vogla të njeriut dhe se ai e shoqëron atë në rrugën e tij. Kështu, lutja është gjithashtu një shprehje e një qëndrimi të brendshëm të karakterizuar nga besimi në Zot.

Kushdo që lutet duhet të dijë gjithashtu, se cilat elemente i përkasin lutjes. Kjo do të diskutohet më poshtë.

Qëndrimi i brendshëm dhe i jashtëm

Në fillim lutja zakonisht përfshin një shprehje të caktuar fizike: për shembull, palosjen e duarve për të sinjalizuar se nuk është tani i zënë me punë, por ai që fokusohet tërësisht në bisedën me Perëndinë dhe i ka pushuar të gjitha aktivitetet e tjera. Lutësat, të cilët përkulen në gjunjë përpara Perëndisë tregojnë, që janë të përlulur përpara tij, që e nderojnë atë si të Plotfuqishmin, Madhështorin dhe të Mëshirshmin, kujdesit të së cilit ata i besojnë pa kushte. Kur dikush i mbyll sytë gjatë lutjes, kjo i shërben faktit që asgjë të mos e shpëtojë nga biseda me Perëndinë.

Edhe në qëndrimin e jashtëm, bëhet e qartë se personi që lutet e kupton veten si një njeri i cili është plotësisht i përafuar me Perëndinë. Lutja vjen nga nevoja e menjëhershme për t'u kthyer te Perëndia, për ta falënderuar Atë për gjithshka që kanë marrë dhe për të kërkuar praninë ose ndihmën e tij. Në lutje pra, njeriu është gjithmonë marrësi, edhe nëse, ashtu si Jezusi në Luka 22.44, ai lufton me Perëndinë ose madje e sfidon atë. Njeriu është pra ai që lutet dhe Perëndia dhënësi dhe dhuruesi. Në fund të fundit në lutje bëhet fjalë rreth mëshirës dhe shpëtimit, që është ajo që njeriu kërkon dhe që Perëndia i jep atij.

Në lutje vetëm Perëndia është përballë teje. Kjo vlen edhe për lutjen e përbashkët dhe lutjen në shërbesën fetare. Ajo nuk u drejtohet atyre që janë të pranishëm, por Perëndisë. Në këtë mënyrë, lutja nuk është as monolog, as fjalim për lutësit e tjerë.

Kushdo që në lutje beson në Perëndinë, do të përjetojë që Perëndia është Ati i dashur dhe i kujdesshën, i cili jep forcë dhe të shoqëron në situata të ndryshme të jetës. Nëse ne e njohim, e pranojmë Perëndinë Atë si Krijues, Jezu Krishtin si Shpëtimtarin dhe Frymën e Shenjtë si krijuesin e ri, atëherë mund ta përjetojmë këtë në lutje. Kështu, nga njëra anë, rrëfimi ynë bëhet pjesë e jetës sonë, në anën tjetër, adhurimi, falënderimi, lutja dhe ndërmjetësimi, të cilat janë pjesë e lutjes, bëhen thelbi i Perëndisë. Prandaj, lutja është një burim i rëndësishëm i njohjes së menjëhershme të Perëndisë. Le të kalojmë në aspektet e përmendura tashmë më lart, të cilat janë njëllor pjesë e lutjes publike dhe private:

Adhurimi

Së pari, lutja është adhurimi – ajo gjë hyjnore, e cila përjetohet si i gjithëpushtetshëm, madhështor, misterioz dhe sublim, dhe që e bën njeriun të dridhet dhe që e magjepsë atë në të njëjtën kohë. Adhurimi bëhet para lutjes dhe ndërmjetësimit. Perëndia, para së gjithash, meriton adhurim, sepse ai tejkalon gjithçka që është drejtpërsëdrejti e përjetueshme, sepse të gjitha kufizimet janë shfuqizuar në të. Në adhurim, njeriu i afrohet me druajtje madhështisë së Perëndisë, i cili gjithashtu vjen në terma të tilla si shenjtëria, plotfuqia, përjetësia.

Ka shumë shembuj të adhurimit në Testamentin e Vjetër dhe të Ri: „Ejani, le të adhurojmë dhe të gjuhëzohemi dhe të përulemi thellë para Zotit që na krijoi“ (Psalmi 95,6). Tek Zbulesa 4,10.11 na janë dhënë gjetet e fjalët e një adhurimi të drejtë: Të njëzet e katër pleqtë bien përmbys përpara atij që rri mbi fron dhe adhurojnë atë që jeton në shekuj të shekujve dhe i hedhin kurorat e tyre përpara fronit, duke thënë: Ti je i denjë, o Zot, të marrësh lavdinë, nderimin dhe fuqinë, sepse ti i krijove të gjitha gjërat dhe nëpërmjet vullnetit tënd ekzistojnë dhe u krijuan.“

Në Testamentin e Vjetër, i vetmi objekt legjitim i adhurimit është Perëndia i Izraelit, i cili është gjithashtu krijues i kozmosit. Testamenti i Ri thotë, se Jezu Krishti dhe Fryma e Shenjtë meritojnë të njëjtin adhurim si Perëndia Atë. Është

Zoti i ngritur dhe i lartësuar që adhurohet. Fryma e Shenjtë adhurohet si prania e Perëndisë dhe krijues i ri.

Qëllimi përfundimtar është për të gjithë njerëzit dhe popujt, si dhe të gjitha fuqitë e dukshme dhe të padukshme në botë, për të arritur adhurimin e një Zoti (Isaija 45,14; Zakaria 14,9.16; Psalmi 96,7–9; Gjoni 4,20–24). Jezu Krishti i ringjallur është gjithashtu Zoti i lartësuar që duhet të adhurohet dhe që adhurohet. Ajo që Perëndia tha në Testamentin e Vjetër, tani zbatohet, thuhet edhe për Krishtin (Filip 2,9–11). Në Ngjitjen drejt qiellit, bëhet e qartë se Jezu Krishti po adhurohet: „Por ata e adhuruan atë dhe u kthyen në Jeruzalem me gëzim të madh“ (Luka 24,52).

Falënderimi

Mirënjohja buron nga siguria, se marrëdhënia me Perëndinë ndikon në jetën njerëzore në tërësi. Ata që falënderojnë, falënderojnë para së gjithash për veten e tyre, për ekzistencën e tyre, pavarësisht nëse ajo është e suksesshme apo jo, e matur sipas mendjes njerëzore. Në këtë falënderim shprehet gjithashtu, që Perëndia është krijuesi dhe mbajtësi i Krijimit të tij dhe se ai e sheh veten si pjesë e këtij krijimi.

Përvoja e të qenurit i mbrojtur, i shoqëruar dhe se me të dikush është i mëshirshëm, e bën njeriun të falënderojë. Falënderimet janë për shkak të dijës, se jeta dhe rrethanat e jetës nuk janë për shkak të rastësisë, por se ato janë të përcaktuara nga dhurimi dhe mohimi i Perëndisë.

Lutja për veten

Ndonjëherë duket se lutja është mbi të gjitha një kërkesë; edhe tek Ati ynë, lutja e Jezusit, ka shumë kërkesa. Drejtimi me lutje ndaj Zotit tregon qartë, se vetëm Perëndia është ai, të cilit mund t'i drejtohesh në të gjitha rrethanat e jetës. Personi që lutet shton situatën e tij të jetës në atë lutje.

Ai që i lutet Perëndisë për diçka, ai dallon në të një ndihmës dhe garantues të jetës. Në lutje njeriu mëson, se Perëndia është zemërgjerë dhe i drejtohet të gjithë njerëzve njëllor. Ai e njeh atë si dikush që i plotëson dhe i mohon kërkesat. Një kërkesë në lutje bazohet mbi njohurinë, që Perëndia i drejtohet krijesës së tij dhe e do atë. Perëndia nuk është larg dhe nuk është indiferent ndaj krijesave të tij, por i shoqëron dhe ruan ato. Ai dëshiron ta bëjë të mundur për ta shpëtimin dhe jetën e përjetshme.



Photo: Africa Studio - Fotolia.com

Ndërmjetësimi (lutja për tjetrin)

Ndërmjetësimi buron nga njohuria, se besimtari nuk e jeton vetëm besimin e tij, por në bashkësi me besimtarët e tjerë. Për më tepër, adhuruesi e njeh veten si një imazh të Perëndisë, i cili është i lidhur me njerëzit e tjerë - sepse ata janë gjithashtu imazhi i Perëndisë - dhe është me ta në bashkësinë e krijesave të Perëndisë.

Ndërmjetësimi është gjithashtu pasojë e urdhëresës së dashurisë ndaj tjetrit. Kërkesa që Perëndia mund të ruajë, të mbrojë dhe t'u sjellë shpëtim të tjerëve, mbron besimtarin nga rreziku i dëshirës së shpëtimit vetëm për vete.

Përmbledhje

Çdo gjë që njeriu ndjen brenda vetes dhe çfarëdo që përndodh në zemrën e tij, nevojat dhe dëshirat e tij personale dhe nevojat dhe dëshirat e të tjerëve, janë pjesë e lutjes. Po ashtu, frika dhe gëzimet, të shëndoshët dhe të sëmurët, jeta e vdekur, bukuria e natyrës dhe të qenurit njerëzor në bashkësi dhe për njëri-tjetrin, por edhe shkretëtira, shkatërrimi që njeriu kryen në natyrë dhe ndër njerëz të tjerë, i takon lutjes. Pra, lutja është e domosdoshme për një jetë që përcaktohet nga besimi dhe ndjekja pas.

Masthead

Publikuesi: Jean-Luc Schneider, Überlandstrasse 243, 8051 Zyrh/Zvicër

Shtëpia Botuese Friedrich Bischoff GmbH, Frankfurter Str. 233, 63263 Neu-Isenburg/Germany

Editori: Peter Johanning



Photo: NAK Süddeutschland

| Të përzgjedhur – dhe tani?

Të kërkuar, të përzgjedhur, të thirrur – definicione apo terma qendrore të Ungjillit, të cilat edhe përfshijnë dhe kufizojnë. Si është e mundur, kur Perëndia i do të gjithë njerëzit? Mendime nga një shërbesë fetare e apostulit kryesor.

Shërbesën e parë, nga tre shërbesat fetare të udhëtimit nëpër Afrikë në fund të shkurtit, apostuli kryesor Jean-Luc Schneider e mbajti në Kamerun. Të mërkurën, më 28 shkurt 2018, ai u takua me motrat e vëllezërit në Yaoundé

Njohja e përzgjedhjes

Zbulesa na raporton, se Gjoni pa si vision bashkimin e të përzgjedhurve me Jezusin mbas riardhjes së Tij. Ata, të cilët do të marrin pjesë në rikthimin e Zotit, do të dallohen, do të njihen nga tre faktorë, kjo e thënë nga drejtuesi i kishës internacionale:

- Merita e askujt: Të përzgjedhurit nuk janë zgjedhur nga merita e vet, se e meritojnë, nga forca e pushteti i tyre, porse vetëm nga Perëndia.
- Jo një popull i vetëm. Të përzgjedhurit vijnë nga të gjitha fiset e kombësitë.
- Shumë por me kufi, të kufizuar. Të përzgjedhurit janë të shumtë, por të kufizuar në numër. Kështu e shpjegoi apostuli kryesor Schneider tabllonë e 144.000 vetëve.

Të kuptuarit e përzgjedhjes

Ata, të cilët do të marrin pjesë në rikthimin e Zotit, janë përzgjedhur me qëllim që:

- Të jenë të paralindurit: E për të qenë kështu njerëzit e parë, „të cilët, mbas ringjalljes së tyre, do veshin të parët atë trup të tjetërsuar, të ringjallur të Krishtit“
- Të formojnë bashkësinë-nuse të Krishtit: „Tablloja e dasmës shpjegon, se të parët do të jenë ata, të cilët do të lidhen me shpirt me Jezusin; ata që do të jetojnë me të dhe do të ndajnë gjithshka me Jezusin.“
- Të shërbejnë e sundojnë me Jezusin: Ata nuk do të sundojnë mbi njerëzit, ata nuk do t'i urdhërojnë ata, porse „do të vendosen në shërbim të shpëtimit të njerëzve“ me gjithë forcën e tyre.

Forcimi i përzgjedhjes

- Të përzgjedhurit mbartin emrin e Perëndisë. Ata i përkasin Perëndisë: „Jezusi na ka blerë nëpërmjet sacrificës së tij. Djalli nuk ka më të drejtë ndër ne“. Dhe të zgjedhurit ndjekin thirrjen e tij: „Ti u bëre fëmijë Zoti, sepse Jezusi të përzgjedhi personalisht e të bleu.“ Dhe ju do të merrni dhuntitë e Shpirtit të Shenjtë: „Siç duket kjo shenjë është edhe simbol i rilindjes nga Uji dhe Shpirti, të cilën ne e morëm nëpërmjet pagëzimit me Ujë dhe me Shpirt të Shenjtë, Vula e Shenjtë.“
- Ata i përmbahen shërbesave fetare. Pasi idhujt të mbajnë larg Perëndisë: „Nëse edukimi, paraja dhe



Apostuli kryesor Jean-Luc Schneider emëroi në atë shërbesë fetare në detyrën e Apostelit për Kamerunin: Ignatius Che Nchi (i 3-ti nga e djathta), për Sierra Leonen: Braima Saffa (i 2-ti nga e djathta) dhe për Nigerinë: Ernest Onyebuchi Onwukwe (i 1-ri nga e djathta)



suksesi bëhen më të rëndësishëm për ju sesa Jezu Krishti, keni zgjedhur një idhull. Idhujtaria përfshin edhe magjinë dhe spiritualizmin: „Ju nuk i besoni Jezusit më shumë për të marrë atë që dëshironi, prandaj shikoni diku tjetër. Kjo është idhujtaria.“ Edhe predikuesit mund të bëhen një rrezik në besim: „Edhe kjo është idhujtari: Kur njerëzit e mbajnë veten për më të rëndësishëm se Jezu Krishti.“

- Ata e ndjekin Jezusin pas. Të ndjekësh pas do të thotë të duash të jesh gjithnjë bashkë me Jezusin: „Në shërbesë fetare. Në lutje. Dhe veçanërisht në marrjen e Darkës së Shenjtë.“ Të përzgjedhurit i binden Jezu Krishtit dhe e ndjekin atë pakushte: „Sepse ne e duam atë. Sepse duam të jemi gjithnjë bashkë me të.“ dhe të përzgjedhurit shpërndajnë mesazhin e shpëtimit tek të panjohurit dhe tek mëkatarët: „Ne e duam edhe të huajin, ata që nuk i njohim. Ne i duam të dobtit.“
- Ata janë të panjollësor, të pafajshëm. Të zgjedhurit i njohin mëkatet e tyre dhe pendohen. Prej besimit dhe gatishmërisë për t'u penduar bëhet e mundur falja e mëkateve: „Perëndia mundi t'i lajë, t'ua fshijë mëkatet e tyre. Ata u bënë pa faj.“
- Ata ndoqën apostujt. Nëpërmjet apostujve të zgjedhurit mbartin vulën e shpirtit: „Është Apostulati, të cilit i është ngarkuar detyra për të përgatitur bashkësinë-nuse për ardhjen e Jezusit.“

MENDIME KYCE

Zbulesa 14, 1:

„Pastaj pashë Qengjin në rrinte në këmbë në mal të Sionit, dhe bashkë me të ishin njëqind e dyzet e katër mijë njerëz, që e kishin të shkruar mbi ballin e tyre emrin e tij dhe emrin e Atit të tij.“

Ne u zgjodhëm, për të qenë të paralindurit e Qengjit. Për ta arritur këtë, ne e lemë veten në dorën e Zotit, lemë mënjane të gjitha format e idhujtarisë, shërbejmë duke pasë si shembull Jezu Krishtin, kërkojmë mëshirë dhe ndjekim pas apostujt.



Plani

- 06.10.2018 Setúbal (Portugali)
- 07.10.2018 Sasseiros (Portugali)
- 12.10.2018 Brazilia (Brazil)
- 13.10.2018 Curitiba (Brazil)
- 21.10.2018 Varshavë (Poloni)
- 04.11.2018 Sindelfingen (Gjermani)
- 11.11.2018 Uster (Zvicër)
- 22.11.2018 Palangka Raya (Indonezi)
- 25.11.2018 Bandung (Indonezi)
- 09.12.2018 Pretoria (Afrika e Jugut)
- 16.12.2018 Berlin (Gjermani)
- 23.12.2018 Weimar (Gjermani)
- 25.12.2018 Francë

New Apostolic Church
International

